



## Konkluzionet e forumit të diskutimit lidhur me trajnimin e mësuesve të fizikës

Me 8 shkurt 2025, Instituti Kombëtar i Fizikës në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës, UT, organizuan në Akademinë e Shkencave një forum diskutimi lidhur me procesin e trajnimit të mësuesve të fizikës. Ky aktivitet u ndie i nevojshëm në vijim të kalimit, në vitin 2024, të këtij procesi pranë universiteteve, të cilat u angazhuan denjësisht e me një ndjenjë të madhe përgjegjësie, pavarësisht dilemave lidhur me kohën e lënë në dispozicion për përgatitje dhe programin e parapërcaktuar.

Ky forum pati si qëllim një analizë të procesit të trajnimit në vite si dhe zhvilloi ide për përmirësime të mundshme, në dobi të mësimdhënies së fizikës në sistemin parauniversitar.

Pjesëmarrësit e forumit qenë aktorët kryesorë të këtij procesi, pedagogë të Departamentit të Fizikës, UT, mësues nga shkolla të ndryshme, përfaqësues të MAS si dhe disa anëtarë të Akademisë së Shkencave.

Konkluzionet e forumit po i renditim në vijim:

1. Kualifikimi i mësuesve të fizikës është një proces shumë i rëndësishëm për cilësinë e kësaj trupe dhe për mbarëvajtjen e mësimdhënies së fizikës në arsimin parauniversitar. Problematikat e arsimit në dekadat e fundit lidhen edhe me luhatje të ndjeshme që ka patur ky kualifikim.
2. Pas një periudhe të gjatë mbi 30-vjeçare zigzagesh, kthimi në universitete i procesit të kualifikimit dhe trajnimit të mësuesve është ngjarje e shumëpritur dhe me impakt pozitiv në arsimin parauniversitar.
3. Në vijim, vendimarrësit në arsim duhet të bashkëpunojnë me universitetet dhe me vetë mësuesit për një platformë më të përshtatshme trajnimi vit pas viti.
4. Universiteteve i duhet lënë një liri sa më e madhe në detajimin e platformës së trajnimit.
5. Universitetet duhet ta ndjejnë këtë proces si një përbërëse të rëndësishme të aktivitetit të tyre dhe duhet të sigurojnë kushte optimale për zhvillimin e tij me salla të mjaftueshme mësimi, të paisura me infrastrukturën e nevojshme. Departamentit të Fizikës në UT i mungon të paktën një sallë tjetër e paisur me projektor.
6. Universitetet duhet të bashkëpunojnë ngushtë me vetë mësuesit, për të gjitha elementet e temat e trajnimit, duke patur në fokus të veçantë punët praktike dhe laboratorike. Duhet marrë në konsideratë edhe kërkesa e mësuesve për ta zhvendosur trajnimin nga ditët e fundjavës në ditët e javës.

Ky lloj bashkëpunimi do të sjellë edhe një afrim më të madh mes fizikanëve universitarë dhe trupës së mësuesve, me efekt pozitiv të dyanshëm.